

SHENIMET SHPJEGUESE

1. Informacion i pergjithshem per Shoqerine

Shoqeria " TIRANA POOLS " sh.p.k. ushtron aktivitet ekonomik ne fushen e projektimit dhe te ndertimit te pishinave , shatervane etj. dhe organizmi i saj rregullohet sipas ligjit 9901 date 14.04.2009 " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

Objekti i kesaj shoqerie eshte projektim e ndertim pishina , shatervane etj..

2. Parimet e pergatitjes se pasqyrave financiare

(a) Deklarata e parimeve kontabel

Shoqeria mban regjistrimet kontabel dhe pergatit pasqyrat financiare ne perputhje me legjislacionin kontabel dhe tatimor ne Shqiperi.

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me Ligjin nr. 9228 date 29 Prill 2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Standardet Kombetare te Kontabilitetit.

(b) Parimet e pergatitjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur mbi bazen e parimit te kostos historike.

Politikat kontabel te meposhtme jane zbatuar per pasqyrat financiare.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Keto pasqyra financiare jane pergatitur ne Leke (monedha Shqiptare) ne perputhje me legjislacionin kontabel ne Shqiperi.

3. Politikat kontabel kryesore

(a) Transaksionet ne monedha te huaja

Transaksionet ne monedha te huaja jane konvertuar ne Leke duke perdorur kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Fitimet dhe humbjet nga kembimet per keto transaksione dhe rivleresimet me kursin e fundit te vitit te mjeteve monetare dhe te drejtave dhe detyrimeve ne monedha te huaja jane njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

(b) Mjetet monetare

Aktivet monetare perbehen nga gjendja ne arke dhe ne llogarine bankare.

Gjendja e arkes 51,837 leke dhe e bankes 764,155 leke perputhet me tepricen e llogarive analitike te tyre si dhe me nxjerrjet e llogarive ne bankat perkatese.

(c) Llogarite e arketueshme

Llogarite e arketueshme jane vleresuar me koston e tyre minus borxhin e keq, nqs ka.

Gjendja e kerkesave te arketueshme eshte 10,276,887 LEK nga te cilat

- 8,070,989 LEK kerkesa nga klientet per fatura te paarketuara deri me 31/12/2021;
- 3,967 LEK tatim fitimi i akumuluar i paguar me teper paradhenie;
- 145,984 LEK gjendje e TVSH se kreditueshme;
- 2,055,947 LEK kerkesa te tjera te cilat perfaqesojne materiale te vendosura ne objekte per te cilat eshte marre paradhenie dhe nuk jane perfunduar punimet akoma.

Vlersimi i inventarit

Njesia ekonomike ka vleresuar inventarin me vleren me te ulet midis koston dhe vleres neto te e realizueshme

Gjendja e inventarit sipas inventarizimit fizik te kryer me 31/12/2021 rezulton ne shumen 23,264,184 LEK nga te cilat lende te para e materiale ne shumen 11,123,175 LEK dhe mallra rezulton ne shumen 12,141,009 LEK

Lista e inventarit i bashkangjitet ketyre pasqyrave.

(d) Aktivete afatgjate materiale*(i) Njohja dhe vleresimi*

Aktivete materiale jane vleresuar me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvleresimi (nqs ka).

Gjendja e aktiveve me vlere te mbetur 206,537 leke. Levizja e aktiveve rezulton

Emertimi	Pajsje zyre	Mjete transporti	Pajsje informatike	Instalime teknike e makineri	Totali
<i>Aktive te Trupzuar</i>					
Gjendje 31.12.2020	958,300	0.00	110,550	361,634	1,430,484
Shtesa	0	0.00		0	0
Pakesime		0.00			
Gjendje 31.12.2021	958,300	0.00	110,550	361,634	1,430,484
<i>Amortizimi</i>					
Gjendje ne 31.12.2020	866,493	0.00	86,828	270,626	1,223,947
Shtesa llogaritur	18,361	0.00	5,931	18,202	42,493
Pakesime	0	0.00			0
Gjendje ne 31.12.2020	884,855	0.00	92,758	288,828	1,266,441
Vlera neto 31.12.2019	91,807	0	23,722	91,008	206,537
Vlera neto 31.12.2020	73,445	0	17,792	72,806	164,043

(ii) Amortizimi

Per aktivet afatgjata eshte llogaritur amortizim ne vlere 42,493 leke I cili ka renduar shpenzimet e vitit ushtrimor. Amortizimi eshte llogaritur duke respektuar normat e amortizimit te lejueshme per efekte fiskale.

(e) Detyrime tregtare dhe te tjera

Detyrimet tregtare dhe te tjera jane paraqitur me koston e tyre.

Totali i detyrimeve afatshkurtra eshte 31,716,059 leke nga te cilat:

- 1,974,895 LEK detyrimet ndaj furnitoreve per fature te palikujduara deri me 31/12/2021;
- 3,950,528 LEK te pagueshme ndaj punonjesve te cilat perfaqesojne detyrimet per pagat e papaguara deri ne muajin dhjetor 2021;
- 193,603 LEK detyrimet tatimore te cilat perfaqesojne detyrimet per sigurimet shoqerore ne vleren 177,624 LEK dhe per TAP ne vleren 15,979 LEK;
- 17,538,687 LEK Hua te tjera, pefaqeson detyrimin qe ka njesia ekonomike ndaj ortakeve per shuma te derdhura prej tyre ne fillim te aktivitetit per mbulimin e shpenzimeve;
- Vlera prej 2,931,516 LEK perfaqeson paradhenie te marra per punime te cilat nuk kane perfunduar deri me 31 Dhjetor 2021;

(h)Kapitalet e veta

h.1 Kapitali i nenshkruar rezulton 2.000.000 leke .Nuk ka ndryshime te kapitalit te nenshkruar gjate vitit 2021.

Ai eshte kapital I regjistruar prane QKB

h.2 Rezervat ligjore

Shoqeria nuk ka krijuar rezerva ligjore

h.3 Shoqeria nuk ka fitime te mbartura , pasi me vendim te asamblese se ortakeve date

20/03/2021 eshte vendosur te shperndahet fitimi i vitit 2020 .

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2021	Gjendje 31.12.2020
1	Fitimi/Humbja e pashpermdare	108	0	0
	Totali - Rezerva te tjera		0	0

h.4. Rezultati i ushtrimit

Analiza e ketij zeri perbehet si vijon :

Fitimi (Humbja) e vitit financiar

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2021	Gjendje 31.12.2020
1	Rezultati i ushtrimit	109	805,047	567,275
	Totali - Rezerva te tjera		805,047	567,275

Sic shihet subjekti ka rezultuar me fitim. . Analiza e shpenzimeve perbehet:

1.Shpenzime per personelin*(i) Kontributet per sigurime shoqerore dhe te ngjashme*

Shoqeria, gjate aktivitetit te saj normal, kryen pagesa ne emer te saj dhe aktualisht ka vetem paguar per kontributet per sigurimet shoqerore dhe shendetesore ne pajtim me legjislacionin ne fuqi. Kostot perkatese te bera ne emer te Shoqerise ngarkohen ne pasqyren e te ardhurave me ndodhjen e tyre.

(ii) Leje e zakonshme e paguar

Shoqeria njeh si nje shpenzim personeli ato kosto qe lidhen me lejen e zakonshme atehere kur eshte perdorur nga personeli perkates.

Analiza e ketij zeri perbehet si vijon :

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2021	Gjendje 31.12.2020
1	Sigurimet shoqerore dhe shendetesore	644	413,776	338,444
2	Pagat e personelit	641	2,477,700	2,026,609
	Totali - Sigurimet shoqerore e shendetesore		2,891,476	2,365,053

2.Shpenzimet e tjera

Rubrika shpenzime te tjera perbehet si me poshte

Nr	Emertimi	Nr llog.	Gjendje 31.12.2021	Gjendje 31.12.2020
I	Sherbime nga te tretet			
1	Trajtime te pergjithshme	611	0	5,250
2	Qera	613	30,900	120,000
3	Mirmbajtje dhe riparime	615	0	12,342
4	Sigurime	616	77,034	5,202
5	Kerkime dhe studime	617		
6	Te tjera	618	38,849	5,000

	Totali - Sherbime nga te tretet		146,783	147,794
II	Sherbime te tjera			
7	Personel jashte njesise	621		
8	Shpenzime per koncesione, patenta, licensa dhe te ngjashme	623		
9	Publicitet, reklama	624		
10	Transferime , udhetime, djeta	625		
11	Shpenzime postare dhe telekom unikimi	626	32,577	12,875
12	Shpenzime transporti per blerjet	6271	294,606	211,526
13	Shpenzime transporti per shitjet	6272		
14	Shpenzime transporti per personelin	6276		
15	Sherbime bankare	628	176,168	101,827
16	Taksa tarifa doganore (kur nuk perfshihen ne koston e blerjes)	632	180,565	167,939
17	Akciza (kur nuk perfshihen ne koston e blerjes)	633		
18	Taksa dhe tarifa vendore	634	384,591	0
19	Taksa e rregjistrimit (kur nuk perfshihen ne koston e blerjes)	635		
20	Tatime te tjera (kur nuk perfshihen ne koston e blerjes)	638	55,438	47,557
	Totali - Sherbime te tjera		1,123,944	541,724
III	Shpenzime te tjera			
21	Subevnecione te dhena	653	0	0
22	Shpenzime per pritje dhe perfaqsim	654		
23	Gjoha dhe shperblime	657	281,258	1,416
24	Shpenzime te tjera	658	0	0
	Totali -shpenzime te tjera		281,258	1,416
IV	Te tjera			
25	Te ardhura te tjera (Teprice debitore)	75		
26	Shpenzime per interesa (TD)	667	258,433	375,801
26	Humbje nga kembimet valutore (TD)	669	-401,718	-348,321
27	Te ardhura nga rivlersimi /shitja e AQT (TD)	77		
	Totali te tjera		-143,285	27,480
	Totali - Shpenzime te tjera (I+II+III+IV)		1,408,700	718,414

3. Fitimi (humbja) neto e vitit financiar

Fitimi (humbja) neto e vitit financiar i paraqitur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve detajohet si me poshte:

Rezultati tatimor

Per vitin financiar deri me 31 Dhjetor 2021

Rezultati tatimor

Nr	Enertimi	Nr.llog.	Vlera
1	Rezultati ushtrimor		805,047
2	Shpenzime te panjohura		281,258
3	Gjoha dhe shperblime	657	281,258
4	Shpenzime te tjera	604	
5	Shpenzime te ndryshme(Qera)	654	
6	Amortizme tej normave fiskale	658	0
7	Te tjera	6,701	
8	Totali		1,086,305
9	Minus humbjen fiskale te mbartur		0
10	Fitimi neto fiskal (8+9)		1,086,305
11	Tatim fitimi 15 %		0
12	Fitimi humbja (neto)		805,047

Gjate ushtrimit 2021 shoqeria ka realizuar te ardhura gjithsej 10,070,879 LEK , te deklaruar ne sistemin tatimor jane 11,392,135 LEK , diferenca 1,321,256 LEK eshte diferenca gjendjeve te paradhenieve te marra me 31 dhjetor 2021 me paradhenie te marra me 31/12/2020, sic paraqitet ne pasiv te bilancit, te cilat gjate vitit 2021 jane rritur.


Shpenzimet gjithsej rezultojne ne vleren 9,265,832 LEK.

Per periudhen tatimore 2021 shoqeria " TIRANA POOLS " sh.p.k. rezulton me fitim per shumen 805,258 LEK te ciles pasi i shtohen shpenzimet e panjohura per 281,258 LEK del fitimi fiskal 1,086,305 LEK . Meqenese qarkullimi vjetor eshte me i ulet se 14,000,000 leke shoqeria nuk eshte subjekt i tatim fitimit , per rrjedhoje nuk eshte bere llogaritje e tatimit mbi fitimin.

Tirane me 13/07/2022

HARTUESI

BRUNILDA STEFA



ADMINISTRATORI

LULZIM BERATI

